Vendim nr. 316, datë 06.10.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Marsida Xhaferllari,	Kryesuese
Ilir Toska,	Anëtar
Genti Ibrahimi,	Anëtar

në datën 06.10.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 19 (K) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KUJTIM DOKU**

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 1133 (86-2026-1274), datë 23.04.2026 të Gjykatës Administrative të Apelit; nr. 00-2024-2741(283), datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 27, 49, pika 3, shkronja "e", 50, pika 4, 71 dhe 71/a të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatoren e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi ka shërbyer si oficer aktiv në strukturat e Forcave të Armatosura, deri në datën 18.10.1993, pas së cilës ka përfituar pagesë kalimtare për një periudhë dyvjeçare. Në vijim, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, ai është trajtuar me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

2. Në zbatim të ndryshimeve ligjore të miratuara në vitin 2009 në fushën e sigurimeve shoqërore (*Ligji për Pensionin 2009*), Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (*DRSSH*), Tiranë ka rillogaritur masën e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, duke përcaktuar masën përfundimtare të tij nga data 01.07.2009. Mënyra e llogaritjes së pensionit është kundërshtuar në gjykatë nga kërkuesi.

3. Në përfundim të gjykimit në gjykatat e faktit, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 1842, datë 09.09.2015, ka vendosur, ndër të tjera, detyrimin e DRSSH-së, Tiranë t'i paguajë kërkuesit shumën prej 597.477 lekësh, si diferenca të papaguara të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi për periudhën 01.01.1999 - 30.06.2009.

4. Ndonëse palët në proces kanë paraqitur rekurs, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-1625, datë 14.07.2022, ka vendosur mospranimin e tyre, me arsyetimin se vendimi i kundërshtuar lidhej me të drejta që rrjedhin nga sigurimet shoqërore, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale në shkallë vendi, ndaj, për shkak të natyrës dhe vlerës së çështjes, nuk lejohej ushtrimi i rekursit.

5. Në datën 11.11.2022 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të dhëna për çështjen e tij. Gjykata, me vendimin nr. 23, datë 25.04.2023 (*vendimi nr. 23/2023*), ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesës, duke shfuqizuar vetëm vendimin nr. 00-2022-1625, datë 14.07.2022 të Gjykatës së Lartë, duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në atë gjykatë.

6. Pas rishqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2741 (283), datë 27.06.2024, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë. Gjykata e Lartë ka arsyetuar se

gjykata e apelit duhej të hetonte pretendimet e kërkuesit nën dritën e vendimit unifikues nr. 3, datë 24.11.2016 të Kolegjeve të Bashkuara të saj (*vendimi unifikues nr. 3/2016*), lidhur me ligjin e zbatueshëm dhe me mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm të ushtarakut.

7. Në datën 25.10.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë dhe të vendimit unifikues nr. 3/2016. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr.311, datë 18.12.2024 (*vendimi nr. 311/2024*), ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se kërkuesi nuk kishte shteruar plotësisht mjetet juridike efektive në dispozicion, për sa kohë procesi gjyqësor ishte ende në zhvillim.

8. Në datën 21.05.2025 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në gjykatën e apelit. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.00-2025-2787, datë 15.07.2025, ka vendosur rrëzimin e kërkesës, me arsyetimin se kohëzgjatja e gjykimit të çështjes në shkallë të dytë nuk kishte kaluar 1 vit. Gjithashtu, Gjykata e Lartë ka vënë në dukje se kërkuesi nuk kishte paraqitur paraprakisht kërkesë për përshpejtim pranë gjyqtarit relator në gjykatën e apelit.

9. Në datën 07.10.2025 kërkuesi i është drejtuar përsëri Gjykatës së Lartë me kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit në shkallë të dytë. Edhe kjo kërkesë është rrëzuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. 00-2025-4666, datë 22.12.2025, me arsyetimin se gjykata e apelit ishte në pamundësi objektive ta shqyrtonte çështjen më shpejt, për shkak të ngarkesës së lartë dhe akumulimit ndër vite të dosjeve gjyqësore.

10. Ndërkohë, për sa i takon themelit të mosmarrëveshjes, Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 1133 (86-2026-1274), datë 23.04.2026, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit. Nuk rezulton nëse kërkuesi ka paraqitur rekurs ndaj këtij vendimi.

11. Në datën 15.07.2026 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës për herë të tretë me ankim kushtetues individual, sipas objektit.

II

Pretendimet e kërkuesit

12. ***Kërkuesi***, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se nga vendimet gjyqësore të kundërshtuara i janë cenuar:

12.1.*Parimi i shtetit të së drejtës në drejtim të sundimit të ligjit dhe mënjanimit të arbitraritetit*, pasi, zbatimi i Ligjit për Pensionin 2009 ka sjellë zvogëlimin e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, nga 21 604 lekë në 14 080 lekë, e indeksuar deri në datën 13.02.2016 nga 23 608 lekë në 12 581 lekë. Kjo bie ndesh me qëndrimet e Gjykatës në vendimet nr. 33, datë 24.06.2010 (*vendimi nr. 33/2010*) dhe nr. 2, datë 18.02.2013 (*vendimi nr. 2/2013*), sipas të cilave ndryshimet në skemën e pensioneve nuk duhet të përkeqësojnë ndjeshëm kushtet e jetesës së përfituesve dhe zvogëlimi i pensionit nuk mund të justifikohet me interesa të rëndësishëm publikë.

12.2. *Parimi i hierarkisë së akteve normative,* pasi akti normativ nr. 5, datë 10.11.2010, i miratuar me ligjin nr. 10367/2010, me shumicë të thjeshtë dhe procedurë të përshpejtuar, ka zvogëluar masën e pensionit të parakohshëm të përcaktuar me ligjin nr. 9210/2004, të miratuar me shumicë të cilësuar. Gjykata e Lartë dhe Gjykata Administrative e Apelit, gjatë rishqyrtimit të çështjes, nuk kanë respektuar hierarkinë e akteve normative dhe dispozitat ligjore që rregullonin masën e pensionit të tij për periudhën nga data 01.01.1999 deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, në datën 13.02.2016. Përkundrazi, ato e kanë trajtuar pensionin e parakohshëm për vjetërsi shërbimi si sigurim shoqëror suplementar dhe, duke iu referuar vendimit unifikues nr. 3/2016, kanë lejuar zvogëlimin e ndjeshëm të masës së tij.

12.3. *Parimi i sigurisë juridike dhe mbrojtjes të të drejtave të fituara, së drejtës së fituar,* pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara kanë cenuar të drejtën e tij për pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, të fituar në bazë të ligjeve të viteve 1991 dhe 2004, të cilat garantonin një pension në masën 50% të pagës referuese për 15 vjet vjetërsi shërbimi, duke i shtuar 2% të kësaj page për çdo vit shërbimi mbi këtë periudhë. Zbatimi i vendimit unifikues nr. 3/2016, që kufizon masën e pensionit të parakohshëm në nivelin maksimal të pensionit të pleqërisë, ka sjellë zvogëlimin e përfitimit të tij, në kundërshtim me interpretimin pajtues të Gjykatës në vendimin nr. 33/2010, sipas të cilit rillogaritja e pensionit lejohet vetëm kur sjell pasoja pozitive për përfituesin.

12.4. *Parimi i ndalimit të fuqisë prapavepruese*, pasi Ligji për Pensionin 2009 është zbatuar për rillogaritjen e një pensioni të njohur më parë, duke sjellë zvogëlimin e masës së tij. Në përputhje me jurisprudencën kushtetuese, përfshirë vendimet e viteve 2007, 2010 dhe 2013, rillogaritja e pensionit mund të zbatohej vetëm nëse rezultonte në rritjen e tij. Në rastin konkret, në datën 01.07.2009 ka sjellë uljen e pensionit nga 21 604 lekë në 14 080 lekë, e indeksuar deri në plotësimin e kushteve për pension pleqërie, në datën 13.02.2016, nga 23 608 lekë në 12 581 lekë, duke cenuar të drejtat e fituara sipas legjislacionit të mëparshëm.

12.5. *E drejta për proces të rregullt ligjor, në aspektet e së drejtës për gjykim brenda afatit të arsyeshëm, aksesit në gjykatë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe gjykatës së caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë e ka rishqyrtuar çështjen pas 1 viti e 1 muaji nga regjistrimi i saj, duke tejkaluar afatin ligjor 90-ditor, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit pas 1 viti e 7 muajsh nga regjistrimi, duke tejkaluar afatin ligjor 30-ditor. Gjithashtu, Gjykata e Lartë, edhe pas rishqyrtimit të çështjes në zbatim të vendimit nr. 23/2023 të Gjykatës, nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve të tij.

III
Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

13. Gjykimi kushtetues mund të vihet në lëvizje vetëm nëse përmbushen kriteret paraprake të pranueshmërisë së kërkesës, të parashikuara nga Kushtetuta dhe Ligji Organik i Gjykatës. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Kolegji vë në dukje se kriteret paraprake të pranueshmërisë janë të natyrës kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi qoftë edhe i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues. Gjatë shqyrtimit paraprak të çështjes, Kolegji mund të verifikojë një ose më shumë prej këtyre kritereve, pa qenë i detyruar të ndjekë një radhë të paracaktuar të analizës. Mospërmbushja e njërit prej tyre, me pasojë moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, e bën të panevojshëm verifikimin e kritereve të tjera.

15. Mbi këtë bazë, në rastin konkret, Kolegji çmon të ndalet në kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, për të cilin Gjykata ka theksuar se mbrojtja kushtetuese ka funksion subsidiar, ndaj mund të kërkohet vetëm për një vendim gjyqësor përfundimtar që përmbyll procesin gjyqësor. Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose të korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vet individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese (*shih vendimet nr. 10, datë 07.03.2023; nr. 25, datë 13.10.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Në rastin në shqyrtim, Kolegji vëren se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me dy kërkime: (i) shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit, datë 27.06.2024 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, me të cilin është vendosur prishja e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimi i çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, si dhe të vendimit, datë 23.04.2026 të Gjykatës Administrative të Apelit, e cila, në rigjykim, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit; (ii) shfuqizimin e vendimit unifikues nr. 3/2016 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, që ka unifikuar praktikën gjyqësore lidhur me zbatimin e dispozitave të Ligjit për Pensionin 2009 për llogaritjen e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

17. Për sa i përket kërkimit të parë, Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë për kthimin e çështjes për rigjykim nuk përbën vendim përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues, pasi nuk e zgjidh përfundimisht themelin e mosmarrëveshjes. Në këto raste, kërkuesi ka mundësinë të mbrojë të drejtat dhe interesat e tij gjatë rigjykimit, duke përdorur mjetet juridike efektive në dispozicion dhe, pas shterimit të tyre, t'i drejtohet edhe Gjykatës (*shih vendimin nr. 39, datë*

06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese). Në të njëjtën linjë arsyetimi, Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 311/2024, të dhënë në shqyrtimin e ankimit të dytë kushtetues të kërkuesit, ka vlerësuar se ai nuk kishte shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion, për sa kohë që procesi gjyqësor ishte ende në zhvillim. Në rastin konkret, ndonëse Gjykata Administrative e Apelit ka dhënë vendim pas rigjykimit, procesi gjyqësor nuk rezulton të ketë përfunduar me një vendim përfundimtar, ndërsa kërkuesi ka ende mundësinë ta kundërshtojë vendimin e gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet gjykimit kushtetues.

18. Lidhur me kërkimin e dytë, për shfuqizimin e vendimit unifikues nr. 3/2016, Kolegji vëren se kundërshtimi i kërkuesit lidhet me interpretimin e ligjit të zbatueshëm dhe me mënyrën e llogaritjes së pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas qëndrimit të unifikuar nga Gjykata e Lartë dhe të zbatuar nga gjykatat në çështjen e tij. Në këtë kuptim, pretendimet e kërkuesit nuk kanë të bëjnë me vendimin unifikues të shkëputur nga çështja konkrete, por me pasojat e zbatimit të tij në zgjidhjen e mosmarrëveshjes gjyqësore. Për rrjedhojë, duke qenë se këto pretendime lidhen drejtpërdrejt me themelin e një procesi gjyqësor që ende nuk ka përfunduar, Kolegji vlerëson se edhe për këtë kërkim nuk është përmbushur kriteri i shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion.

19. Gjithashtu, kërkuesi ka parashtruar në ankimin kushtetues individual pretendime për cenimin e së drejtës për gjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm, duke argumentuar se Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar çështjen pas 1 viti e 7 muajsh, ndërsa Gjykata e Lartë, në procesin që ka përfunduar me kthimin e çështjes për rigjykim, pas 1 viti e 1 muaji nga data e regjistrimit të saj. Në këtë drejtim, Kolegji vëren se kërkuesi është kufizuar në evidentimin e kohëzgjatjes së këtyre proceseve, pa paraqitur argumente konkrete të natyrës kushtetuese për të mbështetur pretendimin e tij. Po kështu, Kolegji konstaton se ky pretendim është ngritur vetëm në përmbajtje të ankimit kushtetues individual, pa u shoqëruar me një kërkim në objektin ose në kërkesat përfundimtare të tij për shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Lartë, me të cilin është rrëzuar kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm. Për më tepër, edhe nëse argumentet e kërkuesit do të konsideroheshin si kërkim për shfuqizimin e këtij vendimi, ankimi kushtetues individual në dukje është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

20. Për sa më lart, ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriterin paraprak të shterimit të të gjitha mjeteve juridike efektive në dispozicion përpara se t'i drejtohet Gjykatës. Në këto kushte, analiza e përmbushjes së kritereve të tjera të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual të kërkuesit bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

21. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk plotëson kriteret ligjore për pranimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja "d", të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.